



REPUBLIKA E KOSOVËS /  
 REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO.

C.nr.428/15

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, gjyqtari Naim Meholl, me procesmbajtësen Fetije Pireva, në kontestin e paditëses Kompania e Sigurimeve “ nga Prishtina rr. “ nr. , të cilën e përfaqëson me autorizim kundër të paditurit rr. “ Mitrovice, për shkak të rimbursim dëmi-regres, vlera e kontestit 1475€ , pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 16.10.2017, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania e Sigurimeve nga Prishtina rr. nr.

**II. DETYROHET** i padituri Mitrovice, që në emër të rimbursim dëmi-regres të kompensoj paditëses Kompanisë së Sigurimeve “ nga Prishtina rr. nr. shumën në lartësi prej 1475€euro (një mijë e katërqind e shtatëdhjet e pese euro), si dhe shpenzimet procedurale t’ia paguaj paditëses shumën në lartësi prej 25€ euro, me kamat sikurse për mjetet e deponuara bankare pa destinim të caktuar prej ditës së dorëzimit të padis në gjykatë, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

*Pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Paditësi Kompania e Sigurimeve “ nga Prishtina rr. nr. pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë kundër të paditurit r. “ Mitrovice, për shkak të rimbursimit dëmi-regres, duke cëllar se i padituri me datë 03.01.2014 në ora 22:50 me automjetin e tij , ka shkaktuar aksident trafiku , me ç’rast automjeti me të cilin i padituri ka shkaktuar aksident trafiku ka goditur automjetin “Audi A6” me targa , pronë e , i padituri në momentin e shkakimit të aksidentit ka qenë nën ndikimin e alkoolit. I dëmtuari në këtë aksident , ka bërë kërkesë për kompensim dëmi ndaj paditësit.

Sipas Ligjit nr.04/L-018 Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia të Republikës së Kosovës, Kompania e Sigurimeve ka qenë e obliguar që këtë dëm t’ia kompensojmë të dëmtuarit dhe të njëjtin të rimburosoj nga shkaktari i aksidentit-respektivisht nga i padituri në rastin konkret. Prandaj për këtë çështje paditësja me palën e

tret kanë lidhur pajtim jashtëgjyqësor, me të cilin të dëmtuarin në këtë aksident trafiku, ti paguhet shpërblimi i dëmit në shumë prej 1,475.00€.

Gjykata me dt.28.09.2017 ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, ku në këtë seancë prezantoi i autorizuari i paditëses, ndërsa i padituri mungoi edhe pse ishte ftuar me rregull dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Me propozim të paditësit gjykata e mbajti këtë shqyrtim gjyqësor në mungesë të të paditurit.

Në këtë shqyrtimin gjyqësor i autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare deklaroi, me provat e administruara respektivisht në raportet e policisë vërtetohet se i padituri Mustafe Shabani me dt.03.01.2014 është shkakuar aksident komunikacioni duke i shkakuar dëme material me automjetin e të dëmtuarit. Në momentin e aksidentit sipas raportit të policisë vërtetohet se i padituri automjetin e ka vozitur në ndikimin e alkoolit e cila është e ndaluar në baze të Ligjit për sigurimin e komunikacionit rrugor. Në baze të ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësi neni 14 par.1 nën paragrafi 1.3 lidhur me paragrafin 2 dhe 3 shprehimisht parashihet se shoferi i cili vozit automjetin në ndikimin e alkoolit e humb mbulesën siguruese. Duke i'u referuar dispozitave të njëjta të ligjit për sigurimin e detyrueshëm kompania është e obliguar t'i zhdëmtoi palët e treta dhe pastaj të kërkojë regresin nga shkaktori i aksidentit, gjithashtu lartësia e dëmit vërtetohet në baze të procesverbalit mbi vlerësimin e dëmit të automjetit, fotografive vërtetohet lartësia e dëmit. Prandaj mbi bazën e të gjitha këtyre në kuptimin e dispozitave të LMD-se si dhe sigurimit të detyrueshëm paditëses i krijohet e drejta e subrogimit rimbursimit të shumës së dëmit të paguar ashtu që gjykatës i propozoj që kërkesëpadinë e paditëses për rimbursimin e dëmit në shumën prej 1475 euro me kamat ligjore nga dita e pagesës së dëmit me dt. 24.03.2014 ta miratojë në tërësi si të bazuar si dhe ashtu kërkojmë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të taksës për padi gjithsej shumën prej 25 euro.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat: ka bërë leximin e raportit të policisë te datës 03.01.2014, konfirmimin e sigurimit me vlefshmëri 27.02.2013 deri me 27.02.2014, pajtimin jashtë gjyqësor nr. te datës 07.03.2014, procesverbali mbi dëmtimin të automjetit të datës 22.01.2014, fletëpagesa në shumë prej 1475 euro të datës 24.03.2014, fotografitë e automjetit të dëmtuar të palës së treta, kërkesa për rimbursimin e mjeteve nga ana e paditësit drejtuar të paditurit me datën 09.07.2014.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të lartcekur, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Në bazë të raportit të Policisë mbi aksidentin e komunikacionit me nr. të datës 03.01.2014 dhe foto dokumentacionin e vendit të ngjarjes, gjykata ka provuar fakti se me datën 03.01.2014 në rr. nga Mitrovice, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, në mesë të paditurit nga Mitrovica rr. dhe të dëmtuarit nga Mitrovica, në të cilin aksident dëme materiale ka pësuar automjeti i të dëmtuarit

Në bazë të raportit të Policisë mbi aksidentin e komunikacionit me nr. \_\_\_\_\_ të datës 03.01.2014, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri mban përgjegjësi ekskluzive për demet në këtë aksident pasi që në gjendje të dehur me 1.77 te-alkoolit në organizëm ka drejtuar automjetin edhe pse e ka pasur të ndaluar ta drejtoj automjetin nën ndikim të alkoolit nëse përmbajtja e alkoolit në gjak është më e madhe se 0.5 gr/lit. ose mg/ml, ku me atë rast ka dhurur në kahejën e kundërt të rrugës duke goditur automjetin e palës së dëmtuar i cili në atë kohe ishte i parkuar.

Në bazë të leximit të pasqyrës së pagesës së datës 24.03.2014, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja të dëmtuarit ju është kompensuar dëmi në shumë prej 1475 euro në llogarinë bankare të të dëmtuarit nr. \_\_\_\_\_.

Në bazë të leximit të Ujdisë jashtëgjyqësore të datës 07.03.2011, gjykata ka konstatuar faktin se Paditësja ( \_\_\_\_\_ ) ka lidhur ujdj jashtë gjyqësore me të dëmtuarit \_\_\_\_\_ me anë të së cilës janë dakorduar që të dëmtuarit të i paguhet shuma e të hollave prej 1475 euro, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar me aksident trafiku të datës 03.01.2014.

### *Baza ligjore*

Sipas nenit 14.par 1 nen par.1.3 lidhur me te Ligjit per Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia I cili parasheh që " I siguruari e humbë mbulesën siguruese, kur mjete motorik drejtohet nën ndikimin e alkoolit mbi kufijtë e lejuar ", ndërkaq sipas nenit 14 par. 2 dhe 3 të po të njëjtit Ligj parashihet "Humbja e të drejtave nga sigurimi, siç përcaktohen me dispozitat e paragrafit 1. nën-paragrafët 1.1 deri 1.5, të këtij neni, nuk është me ndikim në të drejtën e palës së tretë në dëmshpërblim, Siguruesi pas përmbushjes së detyrimit nga ky nen dhe paragrafi 3. i nenit 9 të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë rimbursim në procedurë regresi ndaj personit përgjegjës për dëmshpërblimin e paguar, edhe pse personi nuk kishte mbulesë siguruese. Me nenin 227 te Ligji për Komunikacionin shprehimisht është përcaktuar se Shoferit nuk i lejohet ta drejtojë mjetin në komunikacionin rrugor, nëse është nën ndikim të alkoolit dhe nëse përmbajtja e alkoolit në gjak është më e madhe se 0.5 gr/lit. ose mg/ml.

### *Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës*

Gjykata pas vlerësimit të të gjitha provave të lartpërndura dhe thënieve të palës paditëse ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovohet në tërësi sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Kjo ngase në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar është provuar fakti se me datën 03.01.2017 në Mitrovicë Rr. \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ kishte ndodhur aksidenti i komunikacionit, ku shkaktar i aksidentit kishte qenë këtu i padituri \_\_\_\_\_ nga Mitrovica Rr. \_\_\_\_\_, i cili në momentin e shkaktimit të aksidentit ishte nën ndikimin e alkoolit në organizëm 1.77% , dhe në të cilin aksident dëm material kishte pësuar i dëmtuari \_\_\_\_\_ . Po ashtu në bazë të provave të lartcekura, është provuar se këtu paditësja i'a kishte paguar të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit të datës 03.01.2014, shumë në lartësi prej 1475 euro. Andaj mbi bazën e të lartcekurave dhe në kuptim të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe të njëjtën edhe e aprovoi në tërësi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


Gjykata ka administruar edhe prova tjera siç janë: kërkesën për dem shpërblim nga Haxhi Shala, procesverbalin mbi dëmtimin e automjetit, gjykata gjeti se të njëjtat nuk janë me ndikim në nxjerrjen e vendimit, andaj të njëjtat nuk i analizoi veç e veç.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së dhe atë për shpenzimet si në vijim: 25 euro ne emër te taksës për padi.

Nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**C.nr.428/2015 datë 16.10.2017**

**Gjyqtari,**  
**Naim Mehulli**



**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve, pas marrjes se të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.